



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES**

Nr.6769/1prot.

Tiranë, më 24.6.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Mynevere Subashi
Adresa: Posta 32, Tiranë
Tel: 0694803656

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me nr. 6769 prot., dt: 18.6.2024, në të cilën kërkonit të dhënat mbi masën mujore të pensionit, ju sqarojmë si më poshtë:

Referuar sistemit të pagesave të pensione PCAMS, rezulton se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju ka caktuar pension pleqërie, me vendim caktimi pensioni nr. 181, datë 16.03.2007, me datë fillimi pensioni 04.04.2007, me 23 vite e 1 muaj periudhë sigurimi, me masë aktuale pensioni 11.327 lekë dhe total të të ardhurave në pension në shumën 13.085 lekë në muaj.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, duke filluar nga data 1 maji 2022, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministarave me nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, të gjitha shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore, realizohen nëpërmjet aplikimit on-line, në platformën e-Albania.

Konkretisht, për t’u informuar në çdo kohë në lidhje me të dhënat e pensionit, mund të aplikoni nëpërmjet llogarisë tuaj në portalin e – Albania, tek rubrika “Kontributet dhe Pensione”, kliko shërbimin “Pensioni im”.

Faleminderit për mirëkuptimin.